

VENDIM
Nr. 446, datë 26.7.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në pikën 1/1 shtohet emërtesa “Instituti i Statistikave”.
- b) Në pikën 1/2:
 - i. shtohet emërtesa “Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar”;
 - ii. shfuqizohet emërtesa “Instituti i Statistikave”.
- c) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, emërtesa “Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve” zëvendësohet me emërtesën “Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”.
- ç) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3 dhe kudo në vendim, emërtesa “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave” zëvendësohet me emërtesën “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”.
- d) Në lidhjen nr. 5, që përmendet në pikën 8, emërtesa “Koordinator në Institutin e Statistikave (INSTAT)”, shfuqizohet.
- dh) Lidhja nr. 5/1, që përmendet në pikën 8/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- e) Pas pikës 8/8 shtohet pika 8/9, me këtë përmbajtje:

“8/9. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Drejtor ekzekutiv”, në sekretariatin teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, janë sipas lidhjes nr. 5/9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
- ë) Në lidhjen nr. 6/3, që përmendet në pikën 9/3, në kolonën “Pozicioni”, pas emërtesës “Drejtor drejtorie” shtohet emërtesa “Koordinator – kategoria III-a”.
- f) Pika 9/6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandën dhe Shtabin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, janë sipas lidhjes 6/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
- g) Titulli i lidhjes 6/6, që përmendet në pikën 9/6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandën dhe Shtabin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit”.
- gj) Pika 10/4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“10/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjësit civilë) në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës

Mbështetëse, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel- Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinės dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinės dhe Stërvitjes, Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinės dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, si dhe për punonjësit civilë jomësimore në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës, janë sipas lidhjes nr. 7/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

h) Titulli i lidhjes 7/4, që përmendet në pikën 10/4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” (punonjës civilë) në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel- Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinės dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinės dhe Stërvitjes, Qendrën e Stërvitjes Individuale në Komandën e Doktrinės dhe Stërvitjes, Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, si dhe për punonjësit civilë jomësimore në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës”.

2. Përfshirja për vitin 2018, nëpunësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit të institucioneve të administratës shtetërore, që do të transferohen në përbërje të strukturës dhe të organikës së AKSHI-t gjatë këtij viti, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën pagë mujore me atë që përfitonin përpara transferimit pranë AKSHI-t.

3. Për vitin 2019 e në vazhdim, nëpunësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët deri në momentin e transferimit në përbërje të strukturës dhe të organikës së AKSHI-t përfitonin një pagë më të lartë se paga sipas lidhjes 5/1 (përfshirë edhe nëpunësit e transferuar gjatë periudhës qershor–dhjetor 2018), do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën pagë mujore me atë që përfitonin përpara transferimit pranë AKSHI-t, deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies juridiko-financiare me këtë institucion.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2018:

a) Për INSTAT-in, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturën e Mbetjeve, të fillojnë nga momenti i transferimit të nëpunësve në pozicionet e reja pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse; dhe

b) Për sekretariatën teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, si dhe për përcaktimet në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “h”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë pas hyrjes në fuqi të vendimit.

5. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore ku janë të punësuar nëpunësit/ punonjësit që do të transferohen gjatë vitit 2018 tek AKSHI-i ta njoftojnë këtë të fundit për kategorinë e pagës dhe pagesën aktuale të këtyre nëpunësve/punonjësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit	II-a	1	20.000
Zëvendëstitullar i institucionit. Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	1	15.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t, të atashuar pranë ministrive të linjës dhe të atashuar pranë institucioneve qendrore	III-a/1	1	20.000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor	III-b	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori të sektorëve të atashuar pranë institucioneve rajonale	IV-a	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
	III-b	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t, të atashuar pranë ministrive të linjës dhe të atashuar pranë institucioneve qendrore	III-b	1 ose 2	25.000
Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore	III-b	1 ose 2	15.000
			5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore	IV-b	1 ose 2, ose 3	15.000
	IV-c		5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-a IV-b	1 ose 2, ose 3	0

Për institucionet rajonale/vendore shtesën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh e përfitojnë vetëm nëpunësit e strukturave TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “drejtor ekzekutiv” në Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Drejtor ekzekutiv	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	1 ose 2, ose 3